



Shkodër, 25.04.2019

Thirrje për Ekspert për ndërtim fushatash sensibilizuese

Pozicioni: Ekspert për ndërtim fushatash sensibilizuese në komunitet

Titulli i projektit: “Youth Wave for Human Rights”

Shtyrja e afatit të aplikimit: 13 Maj 2019

Periudha e angazhimit: 8 ditë në total

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Vala rinore për të drejtat e njeriut” zbatohet në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizimin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktiviteteve që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i termave të angazhimit të ekspertit në aktivitetet e parashikuara në projekt.

3. Vendi i zhvillimit të aktivitetit

Aktiviteti do të zhvillohet në hapsirën territoriale të Bashkisë Shkodër dhe Pukë, konkretisht Njesia Administrative Rrethina, Ana e Malit, Rajoni nr. 5 dhe Gomsiqe.

4. Roli dhe përgjegjësitë e Ekspertit

Aktiviteti do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe përfshin rreth 8 ditë pune, nga të cilat:

- 2 ditë konsistojnë në trajnim mbi koncepte teorike, gjenerale, dhe bazike të ndërtimit të një fushate sensibilizuese;
- 4 ditë të parashikuara për orientimin e të rinjve në ndërtimin e planit të aktiviteteve për fushatat që ato do të ndërmarrin në kuadrin e të drejtave të njeriut që do të adresojnë nëpërmjet tyre.

Pas nënshkrimit të kontratës eksperti në bashkëpunim me Koordinatorin e Projektit duhet të sigurohet që organizimi i aktiviteteve të zhvillohet në përputhje të plotë me objektivat e projektit.

5. Kohëzgjatja e kontratës

Aktiviteti nis menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe realizimi i aktiviteteve do të ndjekë planin e aktiviteteve të përshkruar në projekt deri në Dhjetor 2019.

6. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Të zotërojë një diplomë Bachelor në fushën e shkencave të komunikimit ose në fushën e shkencave sociale;
- Të demonstrojë eksperience pune në ndërtim fushatash sensibilizuese/ndërgjegjësuë;
- Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë;



- Të jetë i aftë për punë.

7. Dokumentacioni i nevojshëm

- CV;
- Letër motivuese;
- Kopje e Diplomave;
- Kopje ID.

8. Pagesa

Mënyra e pagesës së ekspertit do të kryhet varësisht nga vullneti i tij në përfundim të të gjitha detyrimeve të listuara apo me disa transe duke i lidhur ato me detyra të përfunduara sipas kontratës që do të lidhet me organizatën.

9. Aplikimi

Aplikimi duhet të dërgohet brënda datës 13.05.2019 me email në adresën: gruajatekgruaja@gmail.com.